



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal Kačanik
-Shërbimi i Kuvendit-

01Nr. 060/01-2257/21
Kaçanik, 29.01.2021

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **I-r (Parë)** e Rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2021 (Legjislatura e VI-të), mbajtur me 29 Janar 2021. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, më fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës, prej 27 anëtarëve të KK, pjesëmarrës në mbledhje ishin të gjithë anëtarët.

Prej strukturave ekzekutive të komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, drejtorët e drejtorive komunale; Ramadush Osmani, Ukshin Qallaku, Festim Neziraj, Fatmir Loku, Diana Reka dhe Zahir Doda, ndërkaq nga zyrtarët e komunës ishin: Bejtulla Dalloshi, Arbnora Kuka dhe Fatlume Guri-Selimi dhe Besnik Bajra.

Nga strukturat vendore, mbledhja monitorohet përmes, Teleprezencës nga Gëzim Sahiti, Zyrtar i lartë për monitorimin e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës në MAPL.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit,
Procesmbajtës, Makfir Malsiu, Zyrtarë e Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli, Të nderuar pjesëmarrës të kësaj mbledhje, së pari iu përshëndeti të gjithëve iu dëshiroj mirëseardhje, kuorumi ekziston, kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, andaj e hapi mbledhjen e I-r (Parë) të Rregullt për vitin 2021, data 29 Janar, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e 11 e Rregullt e Kuvendit të Komunës i vitit 2020;
2. Propozim Rregullorja për organizimin , kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të administratës komunale;
3. Draft Kodi i Etikës;
4. Plani i punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2021;
5. Plani i punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2021;
6. Plani i punës së Komitetit për Shërbime Publike për vitin 2021;
7. Plani i punës së Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara në Kaçanik, për vitin 2021;
8. Propozim Vendim për ndryshim plotësimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës 01Nr. 18863/19 të datës 28.06.2019 për formimin e komisionit të ankesave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës;

9. Rekomandimi i komisionit vlerësues për përzgjedhjen e ofertës ekonomike më të favorshme për dhënie në shfrytëzim afatgjatë (99) vjet kompanisë "NDRIQIMI GROUP" SH.P.K, pronën komunale me Nr. 143-3, sipërfaqe 1.49.95 ha PSH, ZK Doganaj;
10. Rekomandimi i komisionit vlerësues për përzgjedhjen e ofertës ekonomike më të favorshme për dhënie në shfrytëzim afatgjatë (99) vjet kompanisë "MECATYP" KS SH.P.K, pronën komunale me Nr. 143-1, sipërfaqja, 0.93.88.5 ha, PSH, ZK Doganaj;
11. Rekomandimi i komisionit vlerësues për përzgjedhjen e ofertës ekonomike më të favorshme për dhënie në shfrytëzim afatgjatë (99) vjet kompanisë "MURSELI COMPANY" SH.P.K, pronën komunale me Nr. 143-1, sipërfaqja, 0.93.88.5 ha, PSH, ZK Doganaj;
12. Informatë e Kryesuesit të Kuvendit, për aktivitetin e Kuvendit të Komunës për vitin 2020;
13. Informatë e DAK, për përfundimin e Periudhës së Parë të Vitit shkollor 2020-2021;
14. Raport i punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKS) për vitin 2020; dhe
15. Rishqyrtimi i Rekomandimit të komisionit vlerësues për përzgjedhjen e ofertës ekonomike më të favorshme për dhënie në shfrytëzim afatgjatë (40 vjet), kompanisë "KAÇINKA" L.L.C, pronën komunale me numrat: 402-0 dhe 403-0, sipërfaqe: 0,95.48 ha dhe 0.32.99 ha, në ZK Kaçanik i Vjetër, P.SH KK Kaçanik.

Ju njoftojmë së lidhur me pikën e 15, na është adresuar edhe 1 herë për rishqyrtim. Ne, paraprakisht iu kemi drejtuar MAPL si me vepruar në rastin konkret në rastin kur një rekomandim i komisionit vlerësues nuk e merr miratimin në KK. MPL na i ka lënë dy mundësi, 1. Me rishqyrtuar edhe një herë nga KK rekomandimin e komisionit; dhe 2. Zhvillimin e procedurave të ri shpalljes së konkursit. A jeni të pajtimit që kjo pikë të hynë në rend pune. Për votuan shumica, Kundër votuan anëtarët nga NISMA dhe Ekrem Raka, Abstenim nuk pati. Në sajë të kësaj del konstatimi pika 15 hynë në rend pune. Atëherë kjo pikë futet në rend pune si pikë e 15 e radhës. Lidhur me rendin e propozuar të punës e hapi diskutimin:

z. Selim Reka, Bazuar në mbledhjen e fundit të Kuvendit të Komunës, e kemi pa së po kemi telashe me numra në KK. Unë në kërkoj që në këtë mbledhje si pikë e parë e rendit të punës të hynë: Shkarkimi i Kryesuesit të Kuvendit të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit, Si pikë e parë jeni duke propozuar me hyrë kjo pikë në rend pune, cili është arsyeimi i kësaj pike ?

z. Selim Reka, Me arsyetimin se demokracia funksionon me numrin e shumicës, kështu që duhet vijë dikush që ka shumicën me udhëhequr KK.

Kryesuesi i Kuvendit, A jeni të pajtimit që kjo pikë të futet në rend pune. kush është Për ?

z. Ekrem Kyçyku, Në emër të LVV, kërkoj 5 minuta pushim për konsultim.

5 minuta pushim iu lejuan LVV për konsultime dhe subjekteve tjera politike që dëshirojnë, ndërkaq pas një pauzës 5 minutave, vazhduan punimet e mbledhjes.

Kryesuesi i Kuvendit, Meqë patëm një propozim për votëbesimin e Kryesuesit të Kuvendit, që për mua është i pranueshëm ky propozim, por i pa arsyeshëm. I pranueshëm është për vet faktin se unë duhet t'i përgjigjem vullnetit të KK, ndërkaq i paarsyeshëm së si u kërkuar pa asnjë arsyeim. Qëllimi dihet, kjo ka me u kuptuar kur të vijmë të ajo pikë e rendit të punës. Edhe pse nuk është në rregull në aspektin procedural, unë kërkoj mendimin e grupeve parlamentare, sepse propozimet duhet të vijë me herë ashtu siç e parashohin rregullat e

procedurës. Sidoqoftë kërkoj nga grupet parlamentare se a jeni të pajtimit të futet në rend pune: Propozimi për shkarkimin e Kryesuesit të KK ?

z. Nexhat Loku, Në emër të PDK konfirmoj së ne do të votojmë Kundër propozimit të Selim Reka.

z. Ekrem Kyçyku, Ne emër të grupit parlamentar të LVV konfirmoj së do të votojmë Kundër propozimit që doli, për shkak së nuk ishim të informuar paraprakisht, dhe arsyeja tjetër është së, shkarkimi i Kryesuesit të KK bëhet me 2/3 e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të KK.

z. Selim Reka, Në emër të LDK konfirmoj së ne jemi Për shkarkimin e Kryesuesit të KK, ndërkaq nuk është e vërtetë që thuhet së Kryesuesi i KK shkarkohet me 2/3 e votave, sepse shkarkimi i kryesuesit bëhet me shumicë votash. Ne e dimë së vazhdimisht kemi qenë në sy të kritikës nga opozita se ju jeni përkrahës i PDK. Në këtë rast po dihet së kush qenka përkrahës i PDK-së.

z. Bekim Koxha, Në emër të subjektit politik NISMA, konfirmoj së jemi Kundër propozimit i cili doli. Ne mendojmë së në këtë kohë kur i kemi zgjedhjet parlamentare dhe zgjedhjet lokale nuk e shohim të arsyeshme shkarkimin e Kryesuesit të Kuvendit, ndërkaq nëse jeni edhe bash me shkarkuar, vendosë shumica në KK, ndërkaq ne do të votojmë kundër.

znj. Rabije Sallahu, Edhe subjekti politik i AAK, do të votoj Kundër shkarkimit të Kryesuesit të Kuvendit.

z. Ekrem Raka, Faleminderit Kryesues, E para, subjekti politik ka të drejtë më ngritë iniciativën, por unë nuk pajtohem me thëniet e Kryesuesit të KK të cilat i potencoj. Nuk është faji i Kryesuesit që nuk është shumica e pozitës në KK, faji është i Kryetarit të Komunës. Kryetari i Komunës mund të qeverisë edhe me pakicën, por çështja është së mund të mos kalojnë vendimet. Unë do të Abstenoj në këtë rast, sepse arsyetimi është orientuar gabimisht.

Kryesuesi i Kuvendit, Personalisht i falënderoj të gjithëve për vlerësimin, megjithatë edhe pse u deklaruan të gjitha subjektet politike, unë propozimin e z. Selim Reka për me hyrë në rend pune, Shkarkimi i Kryesuesit të Kuvendit, e shtroj në votim për aprovim; Rezultati i votimit është; Për votuan 4 anëtarët nga LDK, Kundër ishin të gjithë anëtarët tjerë të KK me përjashtim të Ekrem Raka i cili Abstenoj. Në saje të kësaj del konstatimi së Propozimi i z. Selim Reka për me hyrë në rend pune si pikë: Shkarkimi i Kryesuesit të KK, Nuk kaloj. Atëherë rendin e propozuar të punës e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës e,

Aprovoj

Rendin e punës në përbërje prej 15 pikave.

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas radhës:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;

Procesverbali i mbledhjes se kaluar të Kuvendit të Komunës u aprovua njëzëri pa vërejtje.

Aprovoj

Procesverbalin e mbledhjes së XI (Njëmbëdhjetë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës të datës 24. 12. 2020/ Lënda: 01Nr. 060/01-28990/20.

Pyetje dhe Kërkesa

z. Ekrem Kyçyku, Para një muaji është bërë shtrimi me kubëza i trotuarit të Bulevardi “Ismail Raka”, ndërkaq disa kubëza -10 sish, e pash së ishin thyer. Pyetja ime është; A ka përgjegjësi kompania kontraktuese me bërë zëvendësimin e kubëzave të thyera ?

z. Shemsedin Luzha, Faleminderit Kryesues, përshëndetje për të gjithë; Desha t’i bëje disa pyetje Kryetarit të Komunës;

1. Të një restorant afër lumit Lepenc, e kam pa së ishte grumbulluar dheu disa metra lartë, me çka pronat që ishin në anën e majtë në atë pjesë ishin të rrezikuara nga uji. Çka është në pyetje, a duhet me qenë komuna për të gjithë qytetarët e saj e barabartë ?

2. Të mirëmbajtja e rrugëve, nuk e di kush është kontraktuesi, “Eurokos”, nuk e di nëse është kjo kompani, mirëpo punët u pa së nuk janë kryer mirë në rrugën të “Dardha” pjesa poshtë që bien të Stagovët dhe Provollitë.

3. E kam bërë një Kërkesë më herët për vërshimet që janë bërë në një lagje Horun të f. Begracë, ndërkaq askush nuk është marrë me shqyrtimin e kësaj ankese. Unë nuk kam marrë ndonjë përgjigje lidhur me kërkesën e adresuar.

z. Adnan Reka, Kryetar, Përveç defekteve të mëdha që janë evidentuar në rrugën Avdurrahim Shehu te sapondërtuar, siç janë: shtyllat elektrike ne mes te rrugës, pjerrtësia absolutisht e pasakte e rrjedhës së ujerave atmosferike, muret mbrojtëse tanimë janë të plasaritura nga presioni i qarkullimit rrugor, ka lëvizje te trasesë së rrugës, e tjera; dhënia e tenderit në mënyrë të padrejte, ankesat te shumta te banoreve te mashtruar te asaj zone bile edhe duke inkurajuar për t’ju votuar ne zgjedhjet kaluara; unë kam edhe disa informacione te bazuara ne dokumente për keqpërdorime të detyrës zyrtare. Fjala është për ngushtimin e rrugës përballë shtëpisë se inspektorit t’ urbanizmit duke shkelur te gjitha ligjet dhe rregulloret e urbanizmit dhe kadastrit. Kryetar, Si mund ta arsyetoni ndryshimin e kufirit te parcelës se inspektorit në dem të rrugës për 80 m2, e me pas edhe legalizimin e pronës pa përfillur asnjë ligj, ne te gjithë e dimë se shkëmbimi i pronës shkon edhe përmes procedurave të Kuvendit, gjë qe nuk ka ndodhur fare.

znj. Nazife Krasniqi, Përshëndetje për të gjithë, Unë e kam një pyetje për komisioni vlerësues të dëmeve; A është mbledhur ky komision dhe a i ka vlerësuar dëmet e shkaktuara nga vërshimet që janë bërë në kohën e fundit nga reshjet atmosferike ? Kërkoj një përgjigje, sepse sa e di unë, ka pasur bukur shumë dëme të shkaktuara ?

z. Bekim Koxha, Faleminderit, Përshëndetje për të gjithë; Të varrezat e dëshmorëve ende ka mbetur projekti pa përfunduar. Pse po ndodhë kjo, kur do të realizohet ky projekt ? Kjo është një pasqyrë e keqe si komunë. E kam unë një projekt që kisha dashur të realizohet dhe është projektuar në këtë projekt edhe një flakadan. Kërkoj që ky projekt të realizohet sa më shpejtë që është e mundur.

z. Hajredin Luta, Unë e kam një pyetje për drejtorin lidhur me dëmet e shkaktuara në tokat bujqësore në vitin 2019 nga vërshimet e të reshurave atmosferike. Komisioni ka dalë në vendngjarje, i ka vlerësuar dëmet, por nuk kemi përgjigje për kompensimin e dëmeve. Nuk e di a është kjo në përgjegjësi të drejtorit të financave apo të ministrisë. Kërkoj nga drejtoria kompetente të jap një përgjigje lidhur me dëmet e shkaktuara në tokat bujqësore në vitin 2019, dhe arsyen për mos kompensimin e tyre?

znj. Arlinda Raka-Rakoci, Përsëndetje për të gjithë, E kam një pyetje për drejtorin e DAK, Çdo herë kur po ndalet energjia elektrike, nuk po punojnë; Çerdhja e fëmijëve dhe shkolla. Nëse ka mundësi me bërë një zgjidhje në këtë drejtim, do të ishte mirë.

z. Shemsedin Luzha, Kam 2 pyetje për Kryetarin e Komunës;

1. Sa duhet me i bërë dëme komunës, me u shpallë zyrtari me i mirë i komunës ?, pyetje kjo të cilën e kam ngritur më herët, ndërkaq kam marrë një përgjigje, por ajo përgjigje nuk me ka pëlqyer. Kryetari është organi me i lartë ekzekutiv dhe kur vlerësohet një punëtor që nuk ka bërë asgjë, mua me vjen rëndë për shoqërinë tonë.

2. Punëtorët që janë stimuluar që kanë kontribuar gjatë pandemisë, dy nga ta i kam pa që kanë kontribuar, Besnik Dema dhe Besnik Bajra, ndërkaq të tjerët që kanë marrë stimulim, është e tepërt me iu dhënë 600-700 € pa dhënë kurrfarë kontributi.

z. Besim Vishi, Shfrytëzoj rastin të potencoj se edhe në mbledhjet e kaluara kam kërkuar që në rrugët e frekuentuara me vendosur pengesa. Nuk mundem pa e përmendur sa efektive do të ishte sikurse të ishin vendosur pengesa në rrugë. Në këtë rast, unë po iu referohem një rasti që ndodhi me Zekeria Koxha. Singerisht ky rast me ka mërëzitur shumë, ka qenë punëtor shumë i mirë dhe tani realisht ngeh dyshimin ! Po të ishin pengesat e vendosura në rrugë, a do të ishin ndaluar aksidentet e rënda që po ndodhin?

Unë kam dëgjuar së të rinjtë zakonisht edhe me telefon merren vesh së nuk ka në rrugë policë, dhe zhvillojnë shpejtësi të veturave në komunikacion. Shtrohet pyetja, Ku janë policia, për me i ndaluar personat e pandërgjegjshëm që zhvillojnë shpejtësi të madhe në rrugë?

Po dua me përsëritë një kërkesë organit përkatës, që me vendosur sa me tepër pengesa në rrugët e frekuentuara. Rruga për Tetovë, ka kohë me decenie e decenie që ka pasur pengesa në rrugë, dhe çka na pengon neve me vendosur pengesa në rrugë, për mos me i lënë me bërë ushtrime të rinjtë nëpër rrugë me xhipa të fortë.

z. Bekim Koxha, E ceku edhe Shemsedini, Unë në mbledhjen e kaluar kam kërkuar që, për të prekurit prej pandemisë, me i ndihmuar me një shumë simbolike, përfshirë edhe familjet që kanë humbur të dashurit e tyre. Nuk e di a është shqyrtuar kjo çështje apo jo ? Ne i dimë mundësitë tona buxhetore, mirëpo familjet që i kanë humbur familjarët e tyre, t'i përkrahim moralisht me një shumë simbolike, së paku 300€.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë kalojmë në shqyrtimin e pikave të rendit të punës;

2. Propozim Rregullorja për organizimin, kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të administratës komunale;

Kryesuesi i Kuvendit, Materialin e keni marrë, është një rregullore e cila iu ka nënshtruar procedurave të nevojshme, drejtori është prezent në mbledhje, fillimisht fjalën e ka drejtori i DAP, Festim Neziraj.

z. Festim Neziraj, Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë, Kjo rregullore ka ardhur si rrjedhojë e ndryshimit të Statutit të komunës të cilin e ndryshuam në vitin e kaluar. Meqë patëm hyrë në një vit të jashtëzakonshëm si rezultat i pandemisë, jemi detyruar të shtyjme këtë rregullore për me vonë. Në ndryshimet e statutit janë paraparë, shtimi i dy drejtorive komunale, mirëpo ato nuk u votuan që menjëherë të fillojnë me punë të ndara, kështu që kjo është arsyeja që nuk jemi ngutur shumë. Në këtë rregullore janë përfshirë të gjitha shërbimet e komunës,

duke paraqitur edhe detyrat specifike të gjithë sektorëve dhe njësive tjera të administratës komunale, por të keni në dije së kjo rregullore nuk ndikon në shtimin e numrit të punëtorëve, sepse ashtu kështu ne funksionojmë në implementim të Kartën Evropiane për Qeverisje Lokale, ndër të tjerash thuhet së, administrata duhet të jenë e reduktuar e jo numër të numër të punëtorëve që nuk e përballon. Është një formulë që tani nuk me kujtohet saktë. Është më rëndësi të aprovojme këtë rregullore, për kundër vullnetit të disave, kështu për të venë në funksion disa shërbime edhe zyrën e inspektoratit, duhet t'i japim dritën jeshile kësaj rregulloreje. Kjo rregullore ka kaluar edhe procedurat e diskutimeve të brendshme, ashtu siç e përcaktojnë rregullat ligjore.

Kryesuesi i Kuvendit, I dëgjuat sqarimet e drejtorit, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Ekrem Kyçyku, Ne LVV do të jemi kundër miratimit të kësaj rregulloreje. Arsyeja dihet, sepse në këtë rregullore janë përfshirë edhe dy drejtori të cilat kanë qenë pazare politike PDK dhe AAK.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë këtë draft rregullore e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua me shumicën e votave Për, Kundër ishin 7 anëtarët e LVV, Abstenoj Ekrem Raka. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës vendosi të,

APROVOJ

Rregulloren për organizimin, kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të administratës komunale/ Lënda: 01Nr. 104/01-1911/21.

3. Draft Kodi i Etikës;

Kryesuesi i Kuvendit, Materialin e keni marrë, është një kod për sjelljen zyrtarëve të ekzekutivit dhe të komunës në përgjithësi. Iu njoftoj se në KPF është hequr pasuesi “ngjyrat e pazakonta” të neni 7 pika 2.2. Nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin:

z. Ekrem Raka, Faleminderit kryesues, unë kam disa pakënaqësi të nenet që kanë të bëjnë me ne – zyrtarët e zgjedhur të komunës, të neni 5 paragrafi 2, “Zyrtari politik duhet të respektoj vullnetin e votuesve deri në fund të mandatit duke zbatuar programin politik, si dhe shmangë ndërrimin e partisë gjatë ushtrimit të mandatit”. Kjo me duket e padrejtë, sepse çështja e ndërrimit të mandatit, është çështje etike. Për deri sa ligji nuk e pengon askënd me ndërruar partinë, ky pasues për mua është i papranueshme. Të zgjedhurit e popullit i japin llogari popullit. Të sanksionet, Vërejtja publike – e cila i shqiptohet në mbledhje të kuvendit dhe publikohet në faqen zyrtare të komunës, neni 33 pika 1, kjo masë me duket si në sistemin komunist. Të neni 33 pika 5. 2, dënimi me gjobë deri 15% të pagës për tre muaj, unë nuk e di nëse kjo gjobë a është ligjore. Për shkak të këtyre vërejtjeve, unë nuk mundem të votoj këtë kod të etikës.

z. Besim Vishi, Vërejtjet e mia janë të neni 5 pika 2, që i potencoj edhe z. Ekrem. Ne biseduam edhe më herët së nuk është etike kjo masë e përcaktuar në këtë nen. Ne të gjithë kemi shokë edhe të partive tjera si LDK, AAK dhe LVV kjo nuk është drejtë, se nuk po bëhet kurrfarë etike këtu. Ne nuk mundem me thënë së vetëm elektorati i PDK me ka votuar, kjo nuk me duket e logjikshme, sepse secilin nga ne ka mundësi të kemi marrë ndonjë votë edhe nga partitë tjera.

z. Ekrem Kyçyku, Edhe LVV kërkojmë që pika 2 e nenit 5 të hiqet nga draft kodi i etikës, në të kundërtën ne nuk do të votojmë këtë draft kod.

Kryesuesi i Kuvendit, Para së të merr fjalën drejtori, përgjithësisht ato të cilat u thanë kanë bazë, sepse për deri sa ligji e lejon kalimin e anëtarit në subjekt tjetër, atëherë një kod etik nuk mundet me qenë në kundërshtim me ligjin.

z. Bekim Koxha, Unë jam për atë që këtë pikë, Draft Kodin e Etikës, me shtyrë për mbledhjen vijuese të KK.

Kryesuesi i Kuvendit, Nuk ka nevojë me u shtyrë për mbledhjen vijuese kjo pikë. Ne mund t'i heqim dispozitat e neneve që u propozuan dhe e votojmë draft kodin e etikës.

z. Festim Neziraj, E ndiej vetën të obliguar me dhënë një sqarim; Ky draft nuk ka ardhur me lënduar dike apo me iu vënë juve në lajthitje. E kuptoj rëndësinë që ka KK dhe të gjithë anëtarët e zgjedhur të popullit, mirëpo si dokument kam marrë pjesë edhe unë në Asociacion të Komunave të Kosovës dhe iu themi me bindje të plotë së shumica e komunave e kanë këtë mostër pa hequr asnjë nen. Kur thuhet se zyrtari publik duhet respektoj vullnetin e votuesve, nuk do me thënë së është shmangur ndërrimi i partisë. Ky është një dokument i cili është mirë të votohet ashtu si iu ka ardhur. Edhe të "ngjyrat e pazakonta" që u propozua me u hequr në KPF, kujtoj se edhe ai pasues ka qenë në rregull, mirëpo është vullneti i juaj me vendosur.

Kryesuesi i Kuvendit, Ligji mbi Zgjedhjet e lejon kalimin e anëtarit nga një subjekt në tjetrin dhe ne mund të bëjmë këtë përmirësim. Atëherë me propozimin e KPF që të neni 7 pika 2. 2 pasuesi "veshjet e pazakonta" me u hequr, Neni 5. 2 me u hequr dhe të Neni 33 pikat, 5.1 dhe 5.2 të hiqen, e shtroj në votim Draft Kodi i Etikës dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës vendosi të,

APROVOJ

Kodin e Etikës për Zyrtarët e Komunës / Lënda: 01Nr.02-104/02-1688/21.

4. Plani i punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2021;

Kryesuesi i Kuvendit, Materialin e keni marrë, është një plan pune të cilin Ekzekutivi i Komunës e harton çdo fillim viti. Në këtë plan pune janë përcaktuar synimet dhe objektivat e organit ekzekutiv të komunës. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin;

z. Ekrem Kyçyku, Ne LVV jo vetëm këtë plan pune por edhe planet tjera si në pikët 5, 6 dhe 7 do të votojmë Për miratimin e tyre. Planet janë mirë të projektuara, mirëpo çështja është sesa do të realizohen.

z. Bekim Koxha, Edhe ne mendoj së si plan pune është i mirë, mirëpo sesa realizohet po vërehen edhe në terren se si po kryen punët nga Ekzekutivi i Komunës, sepse ka gabime të shumët në ekzekutiv dhe ne nuk jemi të kënaqur me punën e ekzekutivit të komunës. Si plan pune do ta përkrahim, por çështja është që të realizohet ashtu si i ka hije realizimit të një plani pune.

z. Selim Reka, Faleminderit kryesues, Plani është një kopje nga viti i kaluar e sidomos të drejtori e DBPZHR, ku edhe datat nuk janë ndryshuar, kanë mbetur ato të vitit të kaluar. Është mirë se paku këto gabime të përmirësohen të pjesa e kësaj drejtorie.

znj. Nazife Krasniqi, Plani është i mirë, mirëpo çështja është sa do të jetë i zbatueshëm. Unë po ndalem të fusha e shëndetësisë ku thuhet së do të bëhen kontratat për specialistet që na

mungojnë në QKMF. Mundësisht kontratat me u bërë edhe për gjinekolog, se nuk e di gjinekologu a vjen një herë në javë apo jo. Dezinfektimi në kuadër të komunës me u bërë në komunën tonë, sepse nga paslufta kjo nuk është bërë asnjëherë në komunën tonë. Nëse realizohet ky projekt, është shumë mirë, sepse në vitin e kaluar ka pasur insekte, mushkonja për të cilat janë ankuar qytetarët e komunës. Sa e di unë disa komuna e kanë aplikuar me herët. laboratorin me u blerë, kjo është mirë dhe në interes të qytetarëve të komunës.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë Planin e punës së ekzekutivit të komunës e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua me votat Për të gjithë anëtarëve të KK, me përjashtim të Ekrem Raka i cili Abstenoj. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori

VENDIM

Me të cilin e Aprovoj Planin e punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2021 / Lënda: 01Nr. 104/02-2048/21.

5. Plani i punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2021;

Kryesuesi i Kuvendit, Në këtë plan pune janë paraparë aktivitetet e këtij komiteti për 1 vit. Ky komitet është organ i KK dhe plani i tij i punës duhet të aprovohet. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë këtë plan pune e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Ne sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Me të cilin e Aprovoj Planin e punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2021 / Lënda: 01 Nr. 60/01-2016/21.

6. Plani i punës së Komitetit për Shërbime Publike për vitin 2021;

Kryesuesi i Kuvendit, Edhe ky komitet është organ i KK dhe plani i tij i punës duhet të aprovohet. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë këtë plan pune e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Ne sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Me të cilin e Aprovoj Planin e punës së Komitetit për Shërbime Publike për vitin 2021 / Lënda: 01Nr. 60/01-2259/21.

7. Plani i punës së Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara në Kaçanik, për vitin 2021;

Kryesuesi i Kuvendit, Edhe ky komitet është themeluar nga KK, dhe ky plan i punës duhet të aprovohet. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë këtë plan pune e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Ne sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për Aprovimin e Plani të punës së Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara në Kaçanik, për vitin 2021 / Lënda: 01Nr. 60/01-2256/21.

8. Propozim Vendim për ndryshim plotësimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës 01Nr. 18863/19 të datës 28.06.2019 për formimin e komisionit të ankesave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës;

Kryesuesi i Kuvendit, Siç e dini edhe ju, një anëtar i këtij komisioni ka dhënë dorëheqje, andaj duhet plotësohet nga OJQ. Propozimi ka ardhur, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Agim Mani, Kërkoj të përmirësohet një gabim teknik, sepse ky komision është i ankesave, e jo komision vlerësues. Në këtë komision pasi jam anëtar i komisionit është mirë të zëvendësohet edhe anëtari tashmë i ndjerë, Zekeria Koxha, ndërkaq për zëvendësimin e anëtarit nga OJQ, ne LVV do të abstenojmë.

Kryesuesi i Kuvendit, Tani doli edhe propozimi tjetër për zëvendësimin e anëtarit nga Ekzekutivi i Komunës, tashmë të ndjerë, Zekeria Koxha.

z. Festim Neziraj, Për anëtar të komisionit në vend të Zekeria Koxha, nga DBPZHR e propozojmë Ibush Lika. Propozimin po e jap unë, pasi që Kryetari i Komunës ka konflikt interesi.

z. Adnan Reka, Komisionin për Ankesa po e shoh se po i bëni zëvendësimet shumë shpejt dhe kjo është mirë që po bëhen, mirëpo komisioni për vlerësimin e ofertave nuk e ka përbërjen e plotë ka gati që tre muaj, nuk e di pse nuk po e plotësoni.

Kryesuesi i Kuvendit, Komisioni vlerësues është në fund të mandatit, dhe për çdo rast rast formohet komision i ri, kështu që komisioni vlerësues do të formohet i ri. Diskutime të tjera nuk ka, atëherë konstatoj së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për Ndryshim Plotësimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës 01Nr. 18863/19 të datës 28.06.2019 për formimin e komisionit të ankesave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ashtu që ish anëtarët e komisionit: Milazim Salijaj dhe Zekeria Koxha, zëvendësohen me Ardiana Tusha nga OJQ dhe Ibush Lika nga Ekzekutivi i Komunës / Lënda: 01Nr. 104/02-1520/21.

9. Rekomandimi i komisionit vlerësues për përzgjedhjen e ofertës ekonomikisht më të favorshme për dhënien në shfrytëzim afatgjatë (99) vjet kompanisë "NDRIQIMI GROUP" SH.P.K, pronën komunale me Nr. 143-3, sipërfaqe 1.49.95 ha PSH, ZK Doganaj;

Kryesuesi i Kuvendit, Tani kemi ardhur të ajo pika ku duhet me u qortuar kryesuesi. Para se me hapur debatin, dua me diskutuar për këtë çështje dhe me dhënë mendimin tim. Pikë e parë, në këtë proces që nga fillimi, duke parë dorëheqjen e një anëtarit të komisioni, duke parë mos nënshkrimin e një anëtarit tjetër në këtë proces, duke parë procedurën e dhënies në shfrytëzim të këtyre parcelave, unë personalisht pa dashur të mos ndikoj të askush, pa dashur të mos ndikoj në bindjen e askujt, unë do të votoj kundër në tri propozimet për arsyet e mia, për të cilat mendoj së janë shkelur procedurat e dhënie së këtyre pronave në shfrytëzim. Duke u nisur nga ajo që tregojnë procesverbalet e komisionit sesi janë thirrur në intervistë ofertuesit, që mendoj së ligji nuk e lejon. Komunikimi me ofertuesit qoftë edhe nga zyra e prokurimit bëhet përmes emaleve zyrtare të cilat lënë gjurmë së çka u diskutua në mes të komisionit dhe ofertuesit. Në këto intervista ne nuk kemi ndonjë gjurmë se çka kanë diskutuar, përpos asaj që është parë në procesverbal. Shkelja tjetër që është në këtë procedurë, është bërë ri-dizajnim i parcelave me atë që është publikuar në ankand. Në këtë rast, nëse një parcelë është ndarë në dy ofertuesve,

atëherë iu është mohuar e drejta dikujt tjetër që ndoshta kishte ofertuar për një parcelë me të vogël, sepse ata nuk e kanë ditur që kanë me u ndarë ato parcela, logjikisht. Çështja tjetër është së, kemi ofertues që janë shpërblyer me 2 apo 3 herë me parcela të komunës, që mendoj se është dashur me iu lëmë hapësirë edhe të tjerëve. Kemi edhe ofertues që janë refuzuar me arsyetimin se janë kompani transportuese e që ligji nuk kategorizon së çfarë kompania duhet të jetë. Kryesisht duhet shikohet interesi ekonomik i komunës. Unë personalisht po e themi edhe një herë, në fillim e pata mendjen të abstenoj, ndërkaq tani do të votoj kundër, pa dashur ta imponoj mendimin e askujt. Unë nuk do të diskutoj më për asnjërin nga tre rekomandime. Lidhur me këtë pikë e hapi diskutimin:

z. Bekim Koxha, Faleminderit kryesues, ne NISMA socialdemokrate prej fillimit që i keni marrë këto vendime, kemi menduar së kanë qenë të paligjshme dhe duhet shikuar a kanë bazë ligjore apo jo këto vendime. Unë mendoj se ata që kanë vendosur për këto prona, do të shkojnë në përgjegjësi, për shkak së iu kanë dhënë njerëzve pa kritere. Iu kanë dhënë njerëzve 2 ha tokë për një betonjerkë, kjo është turp. Ajo pronë ka qenë e paraparë edhe si zonë industriale, ndërkaq pse nuk iu ka dhënë ofertuesve tjerë, por vetëm një ofertuesit ? Kush ka gisht në këto parregullsi, duhet gjetur fajtori e kush e gjënë fajtorin, fajtorin e gjënë gjykata, ndërkaq se sa është gjykata e përgatitur dhe e angazhuar me i zbuluar këto raste, po shihet. E kundërshtojmë ashpër këtë vendim dhe vendimet tjera janë marrë, por edhe ekzekutivin e komunës që i ka sjellë këto vendime me i votuar. Nesër ka me u bërë vonë, sepse njerëzit kanë më investuar në ato parcela, edhe na nëse ligji funksionon dikur, ato vendime kanë me u shpallë të paligjshme dhe ato prona kanë më iu kthyer komunës, mirëpo mos t'i votojmë këto vendime, mos t'i shkaktojmë dëme komunës, sepse nëse nesër vjen një investitor, ndërkaq nuk këna me pasur prona ku me investuar. Komuna e Kaçanikut nuk ka parcela me iu dhënë investitorëve strategjik për zhvillim ekonomik. Unë po tregoj së ndoshta kam folur shumë për këto çështje, duke iu thënë të mos veproni, së nuk është e mirë, por keni vendosur, e bajshi më shëndet. A është e mirë ? Jo, nuk është e mirë. Edhe ligji duhet vlerësoj këto çështje edhe gjykata. Unë ju bëj thirrje që mos t'i votoni këto rekomandime.

z. Kadri Krivenjeva, Përshëndetje për të gjithë, meqë jam anëtar dhe pjesë e komisionit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, unë do të mundohem në pika të shkurtër me iu sqaruar arsyen së si janë marrë këto vendime. Rekomandimet i keni dhe ankesën, para jush, por unë në pika të shkurta do të mundohem t'ua sqaroj rastin e parë si sqarim, unë do ta lexoj raportin lidhur me një ankesë. Ne si anëtar të komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale ne takimin e mbajtur me 19 janar 2020 ka shqyrtuar raportin e komisionit për ankesa të palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës lidhur me ankesën e datës 13 nëntor 2020 nga NTSH "Beka" dhe "Terziu", SHPK Kaçanik ndaj vendimit 01-104/02-21372 të datës 29 nëntor 2020 të komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës për PK 143-3 në sipërfaqe prej 14.995 m² SHK Kaçanik, me kulturë kullosë e klasës të 3 të "Fusha e Mulës" ZK Doganaj, Komuna Kaçanik. Anëtarët e komisionit e çmojnë angazhimin dhe punën e komisionit të ankesave dhe me kujdes të veçantë ka shqyrtuar vërejtjet në raportin e tyre. Komisioni vlerësues mendon së komisioni i ankesave nuk ka pasur të drejtë të mbështetet në rregulloren nr. 23/2013 e cila nuk është në fuqi dhe është zëvendësuar me rregulloren nr. 09/2020, kjo është për bazë. Po ashtu komisioni i ankesave nuk iu është përgjigjur afatit kohor të cilat janë të specifikuara në nenin 21 procedurat për vlerësimin e ofertave në rregulloren nr. 09/2020. Pastaj, duke u mbështetur në këtë që e potencova, mendojmë së nuk jemi të obliguar të merremi me rishqyrtimin e këtij raporti, mirëpo për shkak të korrektësisë ne kemi vendosur që në përpikëri t'i analizojmë vërejtjet e tyre, sepse operatori ekonomik e ka parashtruar ankesën në këtë kohë.

Duke i analizuar të gjeturat e komisionit të ankesave f. 5 paragrafi 5, që PK 143-2 në ZK Doganaj, nuk iu ka ndarë askujt për shkak së komisioni vlerësues mendon së operatori ekonomik "Ndriqimi Group" SHPK, gjatë intervistimit është deklaruar së nuk ka interesim për të njëjtën parcelë, ndërsa operatori i dytë që ka aplikuar për këtë parcelë, "Terziu Group", SHPK nuk ka qenë i kompletuar me dokumentacion.

Ne mendojmë se kemi vepruar drejtë që kjo parcelë nuk është dhënë në shfrytëzim, sepse herën tjetër ndoshta do të kemi një investitor më serioz. Sa i përket vërejtjes së komisionit të ankesave së komisioni vlerësues nuk ka të drejtë të propozoj apo të dizajnoj ndarje të reja të parcelave, ne mendojmë së konkurrenca e krijuar e ka sjellë një situatë të tillë, ne jemi mbështetur në interesin publik cili është më i madh kur përfshihen të dy operatorët ekonomik (të cilët janë pajtuar me një ndarje të tillë). Në aspektin ekonomik nga një investim 2.205.000€ ose nga investimi tjetër prej 3.700.000€, komisioni vlerësues e ka ngritë në vlerë 5.905.000€, duke i dhënë mundësi të dy operatorëve. Ndërsa sa i përket numrit të punëtorëve nga nr. 70 gjegjësisht 217 me ndarjen e propozuar mundësohet të punësohen 287 punëtor. Prandaj, rekomandojmë që organi kompetent të bëjë ndarjen e propozuar nga komisioni vlerësues. Sa i përket parcelës 143-3 për të cilën është parashtruar ankesa, nga konsorciumi NTSH "Beka" dhe "Tërziu" SHPK me vlerë investive 1.928.500€, ndërsa operatori ekonomik "Ndriqimi Group" SHPK paraqitet me investim inovativ dhe nëse e marrim investimin në proporcion për 3 parcelat e aplikuara vlera investive e tij do të jetë 3.666.666€, i cili është dukshëm më me interes të madh publik.

Kryesuesi i Kuvendit, Parashtroj pyetje komisionit së ku janë ofertat, pse ofertat nuk janë bashkangjitur lëndëve ?

z. Kadri Krivenjeva, Ne jemi të zgjedhur të këtij kuvendi në komision dhe ofertat vlejné për komisionin. Besimin me punuar në këtë komision na i ka dhënë ky kuvend.

Kryesuesi i Kuvendit, Ne duhet të kemi këto lëndët e plota, përfshirë edhe ofertat, në mënyrë që të dimë se çka ka shkruar secili ofertues në ofertën e tij.

Kryetari i Komunës- Besim Ilazi, Nëse juve iu duhen ofertat, ne mundemi të ua sjellim këtu në kuvend.

z. Selim Reka, Në emër të subjektit politik të LDK, konfirmojmë së ne nuk do të marrim pjesë në vlerësimin e parcelave për dhënie në shfrytëzim për periudhën 99 vjet gjatë kohës së fushatës, kështu që ne anëtarët e subjektit politik të LDK nuk do të qëndrojmë në mbledhje. Anëtarët e LDK (Selim Reka, Besnik Salihu, Nazife Krasniqi dhe Arlinda Rakocia-Raka) e lëshuan mbledhjen.

z. Kadri Krivenjeva, Këto lëndë nuk janë në kohë fushatë, por janë në proces që tre muaj.

z. Adnan Reka, Ashtu siç kemi deklaruar edhe ne mbledhjen e kaluar, ne do të jemi kundër të gjitha rekomandimeve që dalin nga ky komision vlerësues për shkak të shkeljes së rregulloreve dhe ligjeve, pa e paragjykuar asnjë ofertues. Kjo nuk është përfillur, ndërkaq kur tani mosmarrëveshjet e juaja kanë pëlcitur, gjerat po dalin në sipërfaqe. Për më tepër Kadriut nëse donë ia përkujtoj saktë se çka ka deklaruar. Kadriu vet ka deklaruar së edhe unë pajtohem me hedhur poshtë këtë konkurs për shkak të procedurave që nuk janë përfillur, bashkë me kryesuesin e komisionit. Me pas, pasi ka ardhur Zekeria dhe ua ka ndryshuar mendjen, këta kanë heshtur, konkursi ka mbetur. Konstatimet e tyre janë së ka pasur shkelje. Ky komision nuk ka qenë kurrqysh. Nëse iu intereson së cilat janë shkeljet e komisionit, ka shumë, ofertat e mbyllura nuk mund të hapen dhe t'i kërkojnë secilit ofertues se çka i mungon në ofertë nga

dokumentet dhe me ua kërkuar cilat nga dokumentet me i sjellë dhe krejt me i relativizuar me i bërë të barabartë për shkak së e shkelë ligjin e konkurrencës. D.m.th. krejt me rend, rregullorja që po e përmend Kadriu, 9/ 2020, rekomandimi duhet jepet brenda 3 ditëve, ndërkaq ne i kemi bërë 2 muaj e nuk kemi dhënë rekomandime. Ne jemi shumë komod si grup, ashtu si iu kemi thënë në fillim, po dalin të gjitha.

Kryesuesi i Kuvendit, Unë po e jap mendimin tim, i dhashë arsytet e mia, ndërkaq ju nuk mundesh me keqpërdorur mendimin tim. Munden më të pëlqyer e munden mos me të pëlqyer, edhe prapavija e votëbesimin e kryesuesit pikërisht në këtë çështje, por po iu tregoj së unë nuk varna nga kjo pozitë.

z. Adnan Reka, Pse këto vërejtje nuk i ke gjykuar me herët, kur unë kam bërë zhurmë më herët dhe kam ofruar dorëheqje, ndërkaq tani kur po ndodhin përplasjet e juaja, po i shihni këto probleme. Si komision ke mundur me na thirrur me na pyetur së ku qëndron problemi.

Kryesuesi i Kuvendit, Këto çështje nuk na janë proceduar për shqyrtim asnjëherë deri me tani dhe unë nuk kam kompetencë me ndërhyrë në punën e komisionit. E drejta ime është me debatuar në kuvend.

z. Bekim Koxha, Edhe një herë po dua me marrë fjalën, pasi foli anëtari i komisionit. Të gjitha subjektet politike (PDK, LVV dhe LDK) keni qenë pjesë e këtij komisioni, dhe nuk e përjashtoj tani si LDK me qarë e më lëshuar mbledhjen, sikurse edhe LVV tani i ikni asaj që e keni votuar që keni qenë pjesë e komisionit. Ne nga fillimi i kemi kundërshtuar këto dhënie të pronave në shfrytëzim nga dita e parë dhe këtu gjërat do të dalin në shesh së diçka fshihet këtu, këto duhet ti vlerësoj gjykata. Në Fushë të Pajtimit iu është dhënë një operatori 2 ha tokë, është turp i madh që iu ka dhënë një operatori 2 ha tokë për ndërtimin e një betonjerke, ne vend që më iu dhënë bizneseve tjera.

Kryesuesi i Kuvendit, Kërkoj nga Bekimi t'i përmbaheni temës, e mos të dal jashtë rendit të punës.

z. Bekim Koxha, Unë e di se e keni fuqinë dhe e keni pasur fuqinë edhe kur i keni marrë ato vendime. Është një e keqe që iu ka bërë komunës që nga dita kur keni marr vendim që iu kanë dhënë në shfrytëzim pronat komunale operatorit, "Muja" edhe operatorit "Gërlica" edhe operatorit në Fushë Pajtimit, së i keni dhënë në mënyrë jo të ligjshme dhe unë mendoj së njerëzit kanë ardhur e janë ankuar shumë qytetarë që kanë pasur dëshirë me i marrë në shfrytëzim ato prona. Këto vendime për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale duhet të ndërpriten.

Kryesuesi i Kuvendit, Dhënien e pronave komunale në shfrytëzim nuk mund të ndalim, sepse është ligji i miratuar në Kuvendin e Kosovës që e lejon këtë çështje, ndërkaq çështja sesa jemi duke e respektuar ligjin, ajo është diçka tjetër. Nuk është kundërligjore dhënie në shfrytëzim e pronës komunale, por duhet me respektuar ligjin, ndërkaq çështja është proceduralisht a kanë shkuar punët mirë, megjithatë e kemi kryetarin e komisionit këtu. Kërkoj mirëkuptimin tuaj që të merr fjalën edhe kryetari i komisionit edhe pse nuk është anëtar i KK.

z. Adnan Reka, Është mirë zotëri i nderuar me i marrë procesverbalet e komisionit, dhe dokumentacionin tjetër me lexuar të gjitha deri në fund së çka kemi punuar ne, e jo me akuzuar, sepse LVV asnjëherë nuk ka qenë kundër investimeve të investitorit të Gjermanisë që

e ka potencuar Kryetari i Komunës në ato shkrimet e veta, por kemi qenë kundër shkeljeve ligjore.

Kryetari i Komunës- Besim Ilazi, Kërkoj nga z. Adnan Reka, mos të filozofoj, së për këto çështje është Zyra Ligjore e MAPL që e bënë vlerësimin. Nëse janë bërë shkelje ligjore, është gjykata.

Kryesuesi i Kuvendit, Të ia kalojmë fjalën kryetarit të komisionit, të elaboroj këto çështje,

z. Besnik Bajra-Kryetar i komisionit vlerësues, Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë, e kam një raport që e kemi përfunduar si komision vlerësues për këto parcela që kanë qenë të parapara me vendim të KK me u dhënë në shfrytëzim afatgjatë dhe afatshkurtër. Shkelje ligjore nuk ka pasur asnjëherë, komisioni asnjë herë nuk ka bërë shkelje ligjore. Sa i përket parcelave që iu ka dhënë kompanisë për betonjerkën, kemi pasur oferta shumë serioze, e kemi shfrytëzuar rastin dhe i kemi ndarë, ka qenë komisioni i formuar nga KK. Janë ligjet-është ligji për dhënien në shfrytëzim me Nr. 06/L- 92 -për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronave të komunës. GZ Nr. 10/03 Prill 2019 si dhe Rregullorja 09/2020. Parcelat i janë dhënë atyre që i kanë plotësuar kushtet, ka ligje, ka gjykata, është raporti përfundimtar i komisionit vlerësues, është raporti i komisionit të ankesave. Qëllimi i këtij ligji Bekim është që të siguroj shfrytëzim efektiv të pronës së paluajtshme të komunës, për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, rritjen e vlerës së paluajtshme të komunës dhe përmbushjen e interesit të përgjithshëm publik. Komisioni vlerësues ka shqyrtuar secilin kërkesë të ofertuesve, duke analizuar dokumentacionin sipas kriterëve të konkursit publik, dhe dokumentacionin shtesë të përpiluar në aplikacion nga komisioni komunal, kam nxjerrë këtë raport; për PK Nr. 402-0 në sipërfaqe 0.95.48 ha dhe PK Nr. 403-0 në sipërfaqe 0.32.99 ha Kaçanik i Vjetër, kullosë e klasës 3 dhe të 4, e destinuar për zonë industriale me vendim të KK, komisioni rekomandon që t'i epet në shfrytëzim afatgjatë për 40 vjet ofertuesi 'Kaçinka' L.L.C si kompani shumë serioze. Kjo kompani do të përqendrohet në investimin, prodhim.

Kryesuesi i Kuvendit, Unë i kam 3 -4 pyetje të shkurtër;

1. Sipas ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës komunale dhe rregullore, A iu lejohet me stërzgatur procesin/?
2. A iu lejohet me bërë rindarje të parcelave juve si komision pa Propozim të DUKMM dhe në kundërshtim me Ankandin publik ?
3. A iu lejohet juve me i intervistuar ofertuesit pa komunikim zyrtar me email apo me shkrim ? dhe
4. Si mundeni më ardhur në KK pa ia bashkangjitur lëndëve, Ofertën e kompanisë konkurruese?

z. Besnik Bajra-Kryetar i komisionit vlerësues, Nuk është puna ime, dokumentacioni që është kërkuar nga zyrtarja e KK ia kemi bashkangjitur lëndës.

Sa i përket ndarjes së parcelave, ne si komision e kemi vlerësuar se ajo parcelë duke i parë ofertuesit shumë serioz dhe mos me i larguar, i kemi thirrur në intervistë, kemi të drejtë me i thirrur në intervistë sipas ligjeve në fuqi, ligjeve për investime strategjike, nëse komisioni vlerësues dyshon në ofertat e kompanive me 30.000 milion euro, ne kemi të drejtë me kërkuar si komision vlerësues mbështetje më të mëdha. Në këtë rast nuk kemi bërë shkelje ligjore, kemi propozuar me i ndarë, ne nuk i kemi ndarë parcelat, ju jeni ata që vlerësoni se a bënë apo jo me u ndarë parcela dhe a bënë me ua dhënë dy kompanive apo nuk bënë. Kjo është shprehje e interesit, ne kemi thirrur ofertuesit me ofertuar, komuna e ka tokën, ofertuesit i kanë paratë dhe ne kemi vlerësuar se komuna përfiton më shumë në një hapësirë, nëse kanë shprehur interes dy

kompani. Është interesi i komunës së shtohet numri i punëtorëve. Dokumentacioni me shkresa është i protokolluar dhe iu ka dërguar kompanive. Sa i përket dokumentacionit të përcjellë me email, është përcjellë me shkresë bashkëngjite-së, janë njoftuar kompanitë, janë thirrur në intervistë dhe kompanitë kanë ra dakord me shfrytëzuar atë pjesë dy kompanitë. Ne jemi ata që e vlerësojmë, ndërkaq ju jeni ata që vendosni. Dokumentacionin e keni përpara, ju vendosni së a jeni me iu ikur investitorët apo jo.

z. Bekim Koxha, Ne nuk jemi kundër investimeve të huaja, por jemi kundër shkeljeve që janë duke u bërë nga ju.

znj. Lirije Luta, Kërkoj nga Kryesuesi i Kuvendit që të marrim fjalën me rend dhe të debatohet me tonë me të ulët, sepse kështu si po diskutohet, nuk po mundemi me kuptuar asgjë.

z. Kadri Krivenjeva, Kryesues, unë nuk e di çka ka të keqe që një parcelë me pëlqimin e dy investitorëve, ku vlera e investimit është diku 5-6 milion euro, apo me ia dhënë një investitori me investime mbi 1 milion euro. Unë po mundohem me sqaruar atë që ne kemi menduar si komision, e sa i përket kërkesës për ndarje të parcelës, ne si komision kemi bërë propozim që interesi i komunës të jetë më i madh, ndërkaq KK është ai që vendosë. Duhet të jemi të qartë, ne nuk kemi ndarë parcela, por kemi propozuar ndarjen e tyre. Është edhe parcela tjetër që është propozuar me u ndarë, unë nuk jam duke kuptuar, se çka po doni me thënë në këtë raast.

Kryesuesi i Kuvendit, Parcelat me i ndarë, është dashur me ia drejtuar DUKMM, dhe pas ndarjes ndoshta ishte rritur edhe më tepër vlera e investimeve. Ankandi e përcakton vlerën e investimeve e jo komisioni.

znj. Kaltrina Kodra (Tafili), Faleminderit kryesues, iu përshëndes, unë po e shoh që kryetari i komunës është shumë i qetë, nuk ka asnjë reagim, unë po pres nga kryetari me dhënë ndonjë reagim këtu e jo në facebook me bërë propagandë kinse ne po e përdorim votën tonë kundrejt qytetarëve. Ne thjeshtë jemi kundër këtyre shkeljeve që janë duke u folur sot, por nuk jemi kundër investimeve.

Kryetari i Komunës- Besim Ilazi, Faleminderit, unë nuk e pata ndërmend me folur, atë që e kam thënë me shkrim e përsëriti edhe sot, për shkak se ligjet ekzistojnë. Ne nuk jemi duke u thirrur ne ligje dhe rregullore që nuk funksionojnë, por jemi duke i respektuar ato. Për shkelje tjera, ne e kemi zyrën ligjore të MAPL që na korrigjon dhe organe tjera të drejtësisë që nëse ka dyshime dikush, me përcjellë. Nuk kam arsye tjetër qysh me thënë, pos që opozita- LVV pa asnjë arsye krejt të thjeshtë krejt banal me thënë e refuzoj një investim. Gjithë jemi dëshmitarë të asaj së duhet hapur dyert investitorëve. Unë me ata që ofertojnë mundohem me i ofruar dhe me iu dhënë përgjigje pozitive. Nuk e dimë a na vjen me i miri apo më i keqi, megjithatë po mundohem me i zbatuar ligjet në fuqi. Kanë qenë anëtarë të komisionit nga KK, ekzekutivi dhe OJQ, unë nuk e di kënd duhet me akuzuar. Po të ishte komisioni nga ekzekutivi, atëherë keni mundur me drejtuar gishtin kah ekzekutivi e me thënë që kryetari po qëndron i qetë. Absolut, mua nuk ma lejon ndërgjegjja mos me plasuar një lajm që ky është realiteti. Arsyetimet ju i thoni, pastaj e ia jepni publikut se cilat janë. Megjithatë nëse ka kush ndonjë vërejtje me të vogël që i ka bërë ekzekutivi apo kryetari i komunës komisionit, iu lutem na thoni, se edhe unë dua me ditur. Për pjesët tjera, unë nuk jam jurist, nuk i njoh procedurat me mirë së kryetari i komisionit dhe komisioni në përgjithësi me sqaruar këtë çështje më mirë, pos që po iu themi së kjo është një lojë demagogjike, për shkak së janë organet tjera që shqyrtojnë se a është e ligjshme apo jo. Edhe nëse kalohen nga zyra ligjore, janë organet tjera. Në këtë rast po ua jap një shembull. Iu kujtohet së Tushaj e ka fituar rastin për 513 mijë euro, kemi shfrytëzuar edhe

mjete të jashtëzakonshme Revizionin dhe e kemi fituar kontestin pa të drejtë ankese dhe iu kanë bllokuar të gjitha gjirollogaritë. Pjesën tjetër e kontrollon dikush tjetër, për atë po themi, nëse ka kush dyshime, urdhëroni e dërgoni së atë jam duke kërkuar. Për këtë po themi së jam shumë komod, së nuk di nga ndikimi ynë së është bërë ndonjë shkelje aq sa e di unë, për atë po themi, nëse ka shkelje, janë organet tjera të cilat na korrigjojnë edhe juve bashkërisht.

znj. Kaltrina Kodra (Tafili), Kryetar në atë mbledhje, kundër nuk ka votuar vetëm LVV, por edhe anëtarë tjerë të KK .

Kryetari i Komunës- Besim Ilazi, Unë kam thënë së LVV e ka kundërshtuar miratimin e rekomandimit për dhënien në shfrytëzim pronën komunale kompanisë “Kaçinka”, ndërkaq të tjerët që kanë votuar kundër, nuk kanë diskutuar. Merrni shikoje shkrimin që e kam bërë, dhe nuk ka asgjë me tepër, pos realitetit që ka qenë në sallë. Nëse e lexon edhe një herë e kupton se nuk paska qenë ashtu.

z. Agim Mani, Faleminderit Kryesues, Jemi në një fazë, ku ende ka hapësirë me debatuar, por jo me këtë tension, t’i ulim të flasim me qetë dhe të dalim me një konkluzion sa më të mirë.

Kryetari i Komunës- Besim Ilazi, Faleminderit Agim, Unë për atë thashë nuk di që ka diçka që ne kemi ndërhyrë në komision, është kryetari i komisionit, jemi ulur kemi biseduar, është anëtar nga OJQ, është kjo e cila u emëruar, ka qenë Milazimi në atë kohë dhe pyetni nëse i kemi bërë ndonjë presion, tani e keni kandidat dhe mundeni edhe me lehtë më biseduar, kështu që nëse është bërë ndonjë parregullsi na e kthen MAPL, gjykata, që ku janë anëtarët e komisionit, nëse ka ndonjë procedurë që është shkelur, unë nuk e di se ka pasur diçka t tillë, merret vendimi, dërgohet në qeveri dhe janë organet tjera që e shqyrtojnë. Nuk ka nevojë as me ngritur as me ulur tension, por me duket e paarsyeshme se të gjithë jemi dëshmitarë që thonë, hajde t’i ofrojmë investitorët me investuar. Unë nuk e di a ka me qenë serioz apo jo, por së paku me letra janë në rregull, e ndoshta nuk ka asgjë as ‘kolicë’, por unë thirrem në dokumentacion se nuk mundem me deshifruar ndryshe.

Kryesuesi i Kuvendit, Ne letrat nuk i kemi hiq, nuk e dimë se çka ka ofruar. Këtë raport ju e keni shkruar Kadri, ku e ka ofertën.

z. Agim Mani, Unë si anëtar i komisionit për shqyrtimin e ankesave, gjatë shqyrtimit të ankesave të një ankuesi kanë dalë në pah parregullsi për shkelje procedurale dhe ligjore, ashtu siç i përmendi rend me rend kryesuesi.

Kryetari i Komunës- Besim Ilazi, A bënë Agim diçka me të pyetur juve dhe kryesuesin; Për do kompani të tjera të cilat iu kemi dhënë prona në shfrytëzim pronat komunale, A i kanë pasur ofertat siç po kërkohen tani këtu për këto kompanitë tjera ?

Kryesuesi i Kuvendit, E kemi ofertën e kompanisë “Kaçinka” L.L.C e cila i ka të gjitha, ndërkaq këto tri tjerat të cilat janë sot në shqyrtim nuk i kanë ofertat, unë nuk e di qysh po i bien kjo punë.

z. Bekim Koxha, Kryetar, më të vërtetë nuk është i mirë ky debat kështu në KK. Ne kemi menduar se Kaçinka më të vërtetë është një investitor strategjik. Fajet këtu nuk i ka kryetari, por fajet i ka komisioni vlerësues.

z. Shemsedin Luzha, Në vitin 1964 iu ka marrë pronë babagjyshit tim pronë e cila ka qenë në emër të katragjyshit i cili ka qenë ballist. Me kalimin e kohës unë e kam kuptuar së nuk ke të drejtë ankese së ka kaluar ajo kohë. pronën e ka marrë një person që nuk është fare i kësaj komune. Unë nuk e di së ku jeni mbështetë kur është dhënë ajo pronë.

Kryetari i Komunës, Pronat i ka shitur AKP, kjo nuk është kompetenca të kryetarit, ti a ke parë që edhe autostradën që e ka bërë qeveria, nuk me ka pyetur nga duhet me ia mbajtur.

z. Shemsedin Luzha, Këtu ka një jo sinqeritet, se komuna jonë e ka të përkufizuar territorin e saj, unë e di që e ka dhënë AKP, por e ka marrë gabim, se prona ka dalë prej “ Ramadan Agushit”, vendimet po merren këtu, personi që e ka marrë pronën time është i Lubishtës, mendoj së kryetari i ka fajet, anën ligjore po ia lëmë zyrës ligjore dhe gjykatës, por ju jeni kryetar i komunës së Kaçanikut. Edhe dalja e autostradës, qytetarët tonë po dalin aty po sakrifikohen. Çfarë përgjegjësie kemi ne që kemi ardhur me votën e qytetarëve të komunës, vetëm me i marrë 208 euro, tensionet janë në KK së çka po ndodhë këtu.

Kryesuesi i Kuvendit, Keni dalë jashtë rendit të punës, është mirë me diskutuar për pikat që janë në rend pune dhe me tonë më të ulët.

z. Shemsedin Luzha, Çfarë veprimesh duhet me marrë kryetar, për tokën e cila ka qenë e baballarëve të mi. Ai ndoshta e ka marrë në formë të rregullt, ka persona tjerë që e kanë të njëjtin problem. Me tregoni ju anën ligjore që duhet marrë unë ? jam në dakord me juve kryesues, por është në pyetje çështja e pronës së Shemsedit, së nesër ndërton në pronën time ai i cili e ka blerë atë pronë.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim për aprovim këtë pikë. Rezultati i votimit ishte, 9 votë Për, 11 votë Kundër, 1 Abstenim (Vlora Dalloshi). Në saje të kësaj del konstatimi së,

Rekomandimi i komisionit vlerësues për përzgjedhjen e ofertës ekonomike me të favorshme për dhënien në shfrytëzim afatgjatë (99) vjet kompanisë “NDRIQIMI GROUP” SH.P.K, pronën komunale me Nr. 143-3, sipërfaqe 1.49.95 ha PSH, ZK Doganaj, Nuk Kaloj / Lënda: 01Nr. 104/02-227/21.

Kjo pronë, Kryesuesi i Kuvendit theksoj së do të Ri shpallet.

10. Rekomandimi i komisionit vlerësues për përzgjedhjen e ofertës ekonomike me të favorshme për dhënien në shfrytëzim afatgjatë (99) vjet kompanisë “MECATYP” KS SH.P.K, pronën komunale me Nr. 143-1, sipërfaqja, 0.93.88.5 ha, PSH, ZK Doganaj;

Kryesuesi i Kuvendit, N]se ka kush diçka e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë, këtë Rekomandim e shtroj në votim për Aprovim. Rezultati i votimit ishte: 9 votë Për, 11 votë Kundër, Abstenoj Vlora Dalloshi. Në saje të kësaj del konstatimi së,

Rekomandimi i komisionit vlerësues për përzgjedhjen e ofertës ekonomike me të favorshme për dhënien në shfrytëzim afatgjatë (99) vjet kompanisë “MECATYP” KS SH.P.K, pronën komunale me Nr. 143-1, sipërfaqja, 0.93.88.5 ha, PSH, ZK Doganaj, Nuk kaloj / Lënda: 01Nr. 104/02-2250/21.

Kjo pronë, Kryesuesi i Kuvendit theksoj së do të Ri shpallet.

11. Rekomandimi i komisionit vlerësues për përzgjedhjen e ofertës ekonomike më të favorshme për dhënien në shfrytëzim afatgjatë (99) vjet kompanisë “MURSELI COMPANY” SH.P.K, pronën komunale me Nr. 143-1, sipërfaqja, 0.93.88.5 ha, PSH, ZK Doganaj;

Kryesuesi i Kuvendit, Para se me hy në shqyrtimin e kësaj pike, iu njoftoj së nuk mund të votoj as për as kundër për shkak të konfliktit të interesit, se e kam kushëri pronarin e kompanisë, kështu që do të abstenoj. E hapi diskutimin:

z. Besim Vishi, Unë nuk jam që një familje të shpërblehet me 3 apo 4 parcela për 99 vjet së kjo është tepër.

z. Kadri Krivenjeva, Askush nuk ka të drejtë që, askujt me ia mohuar të drejtën me aplikuar në konkurs me marrë prona në shfrytëzim, nëse i plotëson kushtet.

z. Besim Vishi, Me letra ju si komision nuk keni të drejtë më ia mohuar askujt me konkurruar, por e drejta ime me dhënë mendimin tim është këtu.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë, këtë Rekomandim e shtroj në votim për Aprovim. Rezultati i votimit ishte: 9 votë Për, 10 votë Kundër, 2 Abstenime, Vlora Dallosi dhe Kryesuesi i Kuvendit Kemal Mërseli. Në sajë të kësaj del konstatimi së,

Rekomandimi i komisionit vlerësues për përzgjedhjen e ofertës ekonomike më të favorshme për dhënien në shfrytëzim afatgjatë (99)vjet kompanisë “MURSELI COMPANY” SH.P.K, pronën komunale me Nr. 143-1, sipërfaqja, 0.93.88.5 ha, PSH, ZK Doganaj, Nuk kaloj / Lënda: 01Nr. 104/02-2253/21.

Edhe për këtë pronë, Kryesuesi i Kuvendi theksoj së do të Ri shpallet.

Kur u votuan pikët, 10,11 dhe 12, në sallë ishin 21 anëtarë.

12. Informatë e Kryesuesit të Kuvendit, për aktivitetin e Kuvendit të Komunës për vitin 2020;

Kryesuesi i Kuvendit, Materialin e keni marrë, Në këtë Informatë jemi munduar me Zyrën e KK me bërë një përmbledhje të aktivitetit të KK në pika të shkurta, ndoshta është dashur me shkruar ende. Kjo nuk miratohet, kështu që konstatoj së Kuvendi i Komunës, u

Njoftua

Me Informatën e Kryesuesit të Kuvendit, për aktivitetin e Kuvendit të Komunës për vitin 2020 / Lënda: 01Nr/ 60/01-1994/21.

13. Informatë e DAK, për përfundimin e Periudhës së Parë të Vitit shkollor 2020-2021;

Kryesuesi i Kuvendit, Fjalën e ka drejtori i DAK, Zahir Doda., për me elaboruar informatën.

z. Zahir Doda- drejtor i DAK, Së pari iu përshëndes të gjithëve, kërkesa ime kur është hartuar kjo Informatë ka qenë me qenë që informata me ma pak faqe, sepse ka dalë me e gjatë sesa e vitit të kaluar. Arsyeja është së, ka qenë një vit pandemie, shpresoj mos t ‘na përsëritet më. Vërtetë kanë qenë rrethanat e jashtëzakonshme, jam munduar me qenë së paku prej natyrës real, më bërë një përshkrim të gjendjes reale. Mendoj se informata është reale, ka ndonjë lëshim aty këtu teknik, në përgjithësi kjo është informata, ky është një lloj raporti i shkurtër, nëse ka ndonjë vërejtje, mund të përgjigjem.

z. Ekrem Kyçyku, Unë po e marrë fjalën vet në mungesë të Kryesuesit për me i shprehur shqetësimet e mia. Na të dhënat e paraqitura, shihet së ka një mospërputhshmëri të kualitetit të arsimtarëve, notave si dhe suksesit. Nga 575 arsimtarëve, 371 janë të kualifikuar, d.m.th. vetëm 4 arsimtarë nuk janë të kualifikuar. Kushtet në përgjithësi në shkolla janë të mira, ndërkaq notat mesatare në shkolla janë të larta, sidomos të niveli fillor. Duhet bërë çmos që cilësia në arsim duhet të ngritet, sepse nuk mendoj se nota mesatare përkon me cilësinë. Të mungesat, është numri shumë i madh i tyre, sidomos mungesat e arsimtarëve. Edhe këtu duhet marrë masa, ekziston Rregullorja e arsimit, drejtorët e shkollave dhe drejtori i DAK duhet me marrë masa.

z. Besim Vishi, Gjatë leximit të raportit më ra në sy numri i madh i nxënësve me nota të dobëta, dhe numri i nxënësve të çregjistruar 33 nxënës. Me intereson për numrin e nxënësve të çregjistruar së çka është bërë me këta nxënës?

z. Adnan Reka, Dihet se Task Forcat janë themeluar në fillim, por a janë ende funksionale, apo janë shpërbërë? ne çfarë i bazoni të dhënat e mësimdhënësve dhe nxënësve të infektuar dhe të shëruar me Covid, kur dihet së shumë pak teste janë bërë nëpër shkolla. Dhe, Drejtor! nuk e di a e keni bërë copy/paste nga raporti i kaluar apo vërtetë ende mendoni se të paktën shkolla e Kovaçëcit është bashkëkohore dhe moderne, kur çatia e shkollës pikon ende, lagështia ka arritur deri në gjysmë të mureve të klasave, dërrasat për mbrojtjen e mureve në klase po bien vetë. Të gjitha llajset e dyshemesë po hiqen, e përplot gjera të tjera. Mua vërtetë po me vjen keq nga nxënësit për mënyrën se si po i edukojmë, duke i mësuar me ndjenjë e fajit qysh në këtë moshë, kinse ata janë fajtor për të gjitha prishjet në shkollë, apo, po i mësojmë se si duhet të kryhen punët nga një kompani, kur paguajmë nga buxheti i komunës. Vetëm një gjë e pranoj, kur jemi të betoni apo rrethojat e shkollave, nuk e keni kursyer fare, po përdoret betonin si asgjë tjetër, sepse betonjerkat duhet të punojnë, sepse kështu e mendoni Ju zhvillimin ekonomik të Komunës. Prandaj, pyetja ime është, Çfarë të ardhme po ndërtoni?

z. Zahir Doda- drejtor i DAK, Numri i madh i mungesave është e vërtetë, por unë e potencova se ka qenë vit jo i zakonit, një vendim i qeverisë na ka sjellë në këtë pozicion. Veç si është ankuar një arsimtar, nuk kam pasur të drejtë më i thënë me dalë në punë. Nuk kam pasur çka me bërë, ky është një realitet që shihet, ndërkaq nuk ka pasur mekanizëm në këtë kohë që ka mundur me ndalur këtë numër të mungesave. Numri i të çregjistruarve, zakonisht të mësimi i obliguar nga 0-9 lëvizin, ose regjistrohen brenda komunës apo jashtë komunës, dhe kështu duhet të çregjistrohet në atë shkollë ku ka qenë. Të çështjet që i përmendi Adnani, Task Forcat janë themeluar dhe janë funksionale. Disa që nuk kanë funksionuar sa duhet, kemi intervenuar, disa kanë dhënë dorëheqje, si në shkollën “Emin Duraku” dhe dorëheqjen e paraqet deri në ministri sikurse të ishte kenë ndonjë dorëheqje që edhe Kombet e Bashkuara, duhet me marrë veshë së çka po ndodhë. Të dorëhequrit plotësohen, Task Forcat realisht mund të themi së kanë funksionuar. Të pjesa tjetër ka defekte në kryerjen e punëve të operatorët, kemi dhënë vërejtje, jap edhe unë vërejtjet. Çështja e cilësisë së punimeve, vërtetë është e dobët dhe është gati e pamundur me bërë diçka me tepër. Të çështja e zhvillimit ekonomik, unë jam për arsim, jo për zhvillim ekonomik, shkollat jam mundur me i rregulluar deri diku, rrethojat janë kërkuar dhe janë duke u bërë.

z. Adnan Reka, Me ndërtuar një objekt të komunës në atë formë, kisha thënë diqysh, ama me ndërtuar shkollë me asi keqpërdorime të operatorëve, kisha thënë jo vetëm unë, por secili nga ne duhet me pasur kujdes, se aty ndërtohet e ardhmja e fëmijëve tanë.

z. Bekim Koxha, Faleminderit kryesues, të cilësia që u përmendi parafolësi, që e ceku edhe drejtori, unë më të vërtetë nuk jam i kënaqur me punët që po i kryejnë operatorët, që po marrin punën. Komuna ka komision të formuar që i mbikëqyrë punimet e projekteve, ai komisioni duhet mbikëqyrë punën, duhet të vlerësoj edhe materialin, e jo fjala vjen, sot t'i vendosim pllakat e nesër të bien. Kjo është e çuditshme çka është duke ndodhur, kush është fajtori? Fajtorin duhet me gjetur ekzekutivi, kryetari. Ne nuk mundemi me i mbikëqyrur punimet atje, por fjala vjen dhe u lëshuar shkolla, kur të shkosh para tre katër ditëve, bien pllakat, pikë objekti, kjo është e palogjikshme.

z. Besim Vishi, të shkolla fillore në Kërbliç, me ka rastisur me shkuar shumë shpesh, shkak u defekteve. Kureshtja është, a ka ndonjë mësues në atë shkollë dhe sa është efektive? Unë asnjëherë nuk kam parë nxënës në atë shkollë, ose shkojnë 5 minuta e i lëshojnë nga mësimi. Nga kureshtja e kam së nuk kam parë nxënës në atë shkollë, sepse me ka ra puna shumë herë me shkuar në atë pjesë. Sa arsimtarë janë në atë shkollë? Sa po me duket mua, ajo shkollë është lënë anash.

z. Zahir Doda- drejtor i DAK, Në shkollën fillore në Kërbliç është vetëm 1 mësimdhënies dhe arsimtar hynë në kuadër të 4 arsimtarëve të pakualifikuar. Asnjë rrugëdalje nuk ka, sepse nuk gjëne operator që i bartë ata fëmijë, se nuk mund të shkohet atje, pos me xhip. Mësimi zhvillohet me një grup nga 1-9 me 7 nxënës janë krejt, ndërkaq arsimtari është nga aty.

Kryesuesi i Kuvendit, Informata nuk del në votim, kështu që konstatoj së Kuvendi i Komunës, u

Njoftua

Me Informatën e DAK, për përfundimin e Periudhës së Parë të Vitit shkollor 2020-2021 /Lënda: 01Nr. 20.01.2021.

14. Raport i punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për vitin 2020;

Kryesuesi i Kuvendit, Ky është një këshill që e ka formuar KK, ky raport nuk votohet, kalon si informatë. A ka kush që donë më marrë fjalën;

z. Agim Mani, Faleminderit kryesues, Sa i përket raportit të KKSB, unë këtë raport në këtë formë të hartuar, e kisha quajtur vetëm informatë. Unë i kam lexuar të gjitha procesverbalet e 5 takimeve që janë mbajtur, shqetësimet që kanë ngritur në atë këshill, kanë dalë me rekomandime të shumta. Sa po e shoh unë, nuk ka pasur llogaridhënie të asnjë dikasteri në këtë raport të KKSB. Nëse bazohemi në këtë raport, raporti është i mangët, raporti duhet me pasur orientim për çështje të sigurisë. Raporti duhet me u bërë edhe në formë diagrami, po e marrë shembull; ku është cekur ruajtja e pyjeve në dy takime, menaxhimi i pyjeve duhet me pasur njëfarë diagrami i cili shkon nga e kuqja në të portokalltën dhe në të gjelbrën. Sa i përket menaxhimit të pyjeve, unë mendoj se është ikona në të kuqën dhe nuk ka llogaridhënie. Në këtë raport ceket për çështje të sigurisë, ndriçimi publik është i mirëseardhur, mirëpo në anën tjetër ekzekutivi i komunës ka marrë vendim me shkyçur ndriçimin publik për me kursyer rrymën, kështu që kjo bien në kontrast me rekomandimet e marra.

z. Besim Vishi, Të rekomandimet që i potencoj z. Mani, unë pajtohem me rekomandimet që i ka dhënë KKSB, por unë nuk pash ndonjë rezultat të arritur në bazë të rekomandimeve të këtij këshilli. Rekomandimet janë më i identifikuar pikat kritike. Pikë kritike kemi pasur edhe nëpër

rrugë për çështje të sigurisë, ka pasur kur shtyllat e betonit janë dëmtuar nga shpejtësia e madhe e automjeteve.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, Në këtë raport bëhet fjalë për një periudhë të përfunduar, informata nuk del në votim, kështu që konstatohet se Kuvendi i Komunës u,

Njoftua

Me Raportin e punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për vitin 2020 /Lënda: 01Nr. 104/02-2146/21.

15. Rishqyrtimi i Rekomandimit të komisionit vlerësues për përzgjedhjen e ofertës ekonomike më të favorshme për dhënien në shfrytëzim afatgjatë (40 vjet), kompanisë “KAÇINKA” L.L.C, pronën komunale me numrat: 402-0 dhe 403-0, sipërfaqe: 0,95.48 ha dhe 0.32.99 ha, në ZK Kaçanik i Vjetër, P.SH KK Kaçanik;

Kryesuesi i Kuvendit, Këtë pikë e futëm në rishqyrtim, lënda është e kompletuar, unë kam votuar Për herën e parë, edhe tani do të votoj njëjtë. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë Rekomandimin e komisionit e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua me 12 votë Për, 6 votë kundër, Abstenuan 3 (Besim Vishi, Albana Lika (Troni) dhe Ekrem Raka). Në sallë ishin 21 anëtarë kur u votua ky rekomandim. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për dhënien në shfrytëzim afatgjatë (40 vjet), kompanisë “KAÇINKA” L.L.C, pronën komunale me numrat: 402-0 dhe 403-0, sipërfaqe: 0,95.48 ha dhe 0.32.99 ha, në ZK Kaçanik i Vjetër, P.SH KK Kaçanik, rekomanduar nga komisioni vlerësues si oferta ekonomike më e favorshme / Lënda: 01Nr. 104/02-30658/20.

Kryesuesi i Kuvendit, Mbledhja i përfundoj punimet në ora 13; 20. Deri në fund të mbledhjes qëndruan 21 anëtarë. Katër anëtarët nga LDK (Selim Reka, Nazife Krasniqi, Besnik Salihu dhe Arlinda Rakoci-Raka) e lëshuan mbledhjen gjatë shqyrtimit të pikës 9, me arsyetim se nuk do të qëndrojmë në mbledhje, për faktin se po diskutohen në kohë fushate për dhënie në shfrytëzim. të pronave komunale. Në ndërkohë nga mbledhja për arsye personale, dolën edhe, Hafize Sallahi dhe Rabiye Sallahi.

Procesmbajtës:
Makfire Malsiu

Makfire Malsiu

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli



REGJISTËR I ANTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS
(të zgjedhur në votimet e datës 22 Tetor 2007);

nga Mbledhja e I-r (Parë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës për vitin 2021, mbajtur me 29 Janar 2021

1. Kemal Mërseli.....,
2. Hamid Guri.....,
3. Ahmet Luma,
4. Kadri Krivenjeva,.....,
5. Besim Vishi,.....,
6. Sali Malsiu.....,
7. Lirije Dema.....,
8. Pranverë Loku- Zharku.....,
9. Lirije Luta.....,
10. Vlora Dalloshi.....,
11. Nexhat Loku,
12. Agim Mani.....,
13. Adnan Reka.....,
14. Ekrem Kyçyku.....,
15. Fatijona Kyçyku.....,
16. Kaltrina Kodra.....,
17. Selim Reka.....,
18. Besnik Salihu,.....,
19. Nazife Krasniqi.....,
20. Arlinda Rakoci-Raka.....,
21. Shemsedin Luzha.....,
22. Albana Lika.....,
23. Rabije Sallahi,.....,
24. Hajredin Luta.....,
25. Hafize Sallahi,
26. Bekim Koxha.....,
27. Ekrem Raka,......



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipality of Kaçanik

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave

Kaçanik, 26.02.2021

Për: Anëtarët e Kuvendit/ **z. Ekrem Kyçyku**
znj. Nazife Krasniqi,
z. Shemsedin Luzha
z. Bekim Koxha
z. Besim Vishi

Lënda: PËRGJIGJE

Të nderuar,

Më lejoni t'ju përgjigjem dhe të jap sqarime zyrtare lidhur me pyetjet/kërkesat tuaja, të parashtruar para Kuvendit të Komunës, më datë, **29.01.2021**

z. Ekrem Kyçyku,

Para një muaji është bërë shtrimi me kubëza i trotuarit të Bulevardi "Ismail Raka", ndërkaq disa kubëza -10 sish, e pash së ishin thyer. Pyetja ime është; A ka përgjegjësi kompania kontraktuese me bërë zëvendësimin e kubzave të thyera ?

- *Kontrata për Projektin "Rehabilitimi i bulevardit "Ismajl Raka" akoma nuk ka përfunduar dhe nuk janë pranuar teknikisht punimet. Çdo defekt që evidentohet gjatë punimeve dhe gjatë periudhës së garancionit është e obliguar kompania që ta evitoj.*

z. Shemsedin Luzha,

1. Të një restorant afër lumit Lepenc, e kam pa së ishte grumbulluar dheu disa metra lartë, me çka pronat që ishin në anën e majtë në atë pjesë ishin të rrezikuara nga uji. Çka është në pyetje, a duhet me qenë komuna për të gjithë qytetarët e saj e barabartë ?

2. Të mirëmbajtja e rrugëve, nuk e di kush është kontraktuesi, "Eurokos", nuk e di nëse është kjo kompani, mirëpo punët u pa së nuk janë kryer mirë në rrugën e quajtur "Rruga e Kuqe" të f. Stagovë.

3. E kam bërë një Kërkesë më herët për vërshimet që janë bërë në një lagje të f. Begracë, ndërkaq askush nuk është marrë me shqyrtimin e kësaj ankese. Unë nuk kam marrë ndonjë përgjigje lidhur më kërkesën e adresuar.

- *Mbushja e parcelave me shtresë dheu është bërë me kërkesa individuale të vetë pronarëve. Planifikojmë që të hapim një kanal për largimin e ujrave atmosferike për gjatë rrugës në mënyrë që të mos paraqiten probleme në rrugë dhe në pronat private.*
- *Kompania "Eurokos" është kompani e kontraktuar nga Ministria e Infrastrukturës për mirëmbajtjen e magjstrales Prishtinë-Hani Elezit dhe kjo kontratë nuk është në kompetencat e komunës.*

- *Komisioni i përkohshëm komunal i formuar për vlersimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet që janë bërë në kohën e fundit nga reshjet atmosferike është mbledhur dhe i ka vlerësuar dëmet e shkaktuara nga vërshimet që janë bërë nga reshjet atmosferike në lagjen e potencuar në fshatin Begracë. Raporti i detajuar edhe me koston financiare është dorëzuar në të gjitha ministrinë e linjeve përkatëse për të ndihmuar rreth dëmeve që janë evidentuar nga komisioni.*

z. Shemsedin Luzha,

Sa duhet me i bërë dëme komunës, me u shpallë zyrtari me i mirë i komunës ?, pyetje kjo të cilën e kam ngritur më herët, ndërkaq kam marrë një përgjigje, por ajo përgjigje nuk me ka pëlqyer. Kryetari është organi me i lartë ekzekutiv dhe kur vlerësohet një punëtor që nuk ka bërë asgjë, mua me vjen rëndë për shoqërinë tonë.

2. Punëtorët që janë stimuluar që kanë kontribuar gjatë pandemisë, dy nga ta i kam pa që kanë kontribuar, Besnik Dema dhe Besnik Bajra, ndërkaq të tjerët që kanë marrë stimulim, është e tepërt me iu dhënë 600-700 € pa dhënë kurrfarë kontributi.

- *Vlerësimi i punëtorëve bëhet nga drejtoria përkatëse bazuar në realizimin e objektivave të synuara nga drejtoria përkatëse. Zyrtarët që kanë arritur t'i realizoj objektivat vjetore normalisht që vlerësohen për punën e tyre.*
- *Gjatë periudhës së pandemisë zyrtarët të cilët janë angazhuar më punë shtesë janë stimuluar për punën në kushtet specifike të pandemisë. Arsyeshmërinë e stimulimit e ka vlerësuar drejtoria përkatëse.*

znj. Nazife Krasniqi,

Përshëndetje për të gjithë, Unë e kam një pyetje për komisioni vlerësues të dëmeve; A është mbledhur ky komision dhe a i ka vlerësuar dëmet e shkaktuara nga vërshimet që janë bërë në kohën e fundit nga reshjet atmosferike ? Kërkoj një përgjigje, sepse sa e di unë, ka pasur bukur shumë dëme të shkaktuara ?

- *Komisioni i përkohshëm komunal i formuar për vlersimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet që janë bërë në kohën e fundit nga reshjet atmosferike është mbledhur dhe i ka vlerësuar dëmet e shkaktuara nga vërshimet që janë bërë nga reshjet atmosferike. Raporti i detajuar edhe me koston financiare është dorëzuar në të gjitha ministrinë e linjeve përkatëse për të ndihmuar rreth dëmeve që janë evidentuar nga komisioni.*

z. Bekim Koxha,;

Të varrezat e dëshmorëve ende ka mbetur projekti pa përfunduar. Pse po ndodhë kjo, kur do të realizohet ky projekt ? Kjo është një pasqyrë e keqe si komunë. E kam unë një projekt që kisha dashur të realizohet dhe është projektuar në këtë projekt edhe një flakadan. Kërkoj që ky projekt të realizohet sa më shpejtë që është e mundur.

- *Në projekt buxhetin e vitit 2021 është paraparë realizimi i projektit "Ndërtim i Memorialit për Viktimat Civile të luftës", ku janë paraparë 10,000.00€. Ky Memorial planifikohet të ndërtohet në Kompleksin e Varrezave të Dëshmorëve dhe Veteranëve të UÇK-së. Investimet në këtë kompleks do të bëhen edhe në vitet vijuese deri në finalizim të plotë të saj.*

z. Besim Vishi,

Shfrytëzoj rastin të potencoj se edhe në mbledhjet e kaluara kam kërkuar që në rrugët e frekuentuara me vendosur pengesa. Nuk mundem pa e përmendur sa efektive do të ishte sikurse të ishin vendosur pengesa në rrugë. Në këtë rast, unë po iu referohem një rasti që ndodhi me Zekeria Koxha. Sinqerisht ky rast me ka mërzhitur shumë, ka qenë punëtor shumë i mirë dhe tani

realisht ngeh dyshimin ! Po të ishin pengesat e vendosura në rrugë, a do të ishin ndaluar aksidentet e rënda që po ndodhin?

Unë kam dëgjuar së të rinjtë zakonisht edhe me telefon merren vesh së nuk ka në rrugë policë, dhe zhvillojnë shpejtësi të veturave në komunikacion. Shtrohet pyetja, Ku janë policia, për me i ndaluar personat e pandërgjegjshëm që zhvillojnë shpejtësi të madhe në rrugë?

Po dua me përsëritë një kërkesë organit përkatës, që me vendosur sa me tepër pengesa në rrugët e frekuentuara. Rruga për Tetovë, ka kohë me decenie e decenie që ka pasur pengesa në rrugë, dhe çka na pengon neve me vendosur pengesa në rrugë, për mos me i lënë me bërë ushtrime të rinjtë nëpër rrugë me xhipa të fortë.

- *Drejtoria e Shërbimeve Publike ka të planifikuara vendosjen e barrierave (policë të shtrirë) në segmentet rrugore të cilat janë të evodentuara si rrezikshmëri e lartë (afër shkollave, objekteve publike, etj.). Zakonisht rrugët lokale që kanë të punuar edhe trotuarin për këmbësorë përgjatë saj nuk praktikohet që të vendosen edhe barrierë (policë të shtrirë) për ngadalsim të shpejtësisë të ngasësve të automjeteve, kur dihen rregullat e shpejtësisë së lejuar në vendbanime.*

Ju falenderojmë për bashkëpunimin tuaj!

Me respekt,



Ramadush Osmani
Drejtor i DSHPE-s

Përgjigje në pyetje, për z. Adnan Reka:

Përgjigjen ndaj jush po e ndajmë në dy pjesë, në atë të pretendimeve për dëmtime të rrugës dhe për pretendimet për keqpërdorime të detyrës zyrtare.

1)

-shtyllat elektrike në mes të rrugës: ne kemi bërë kërkesë tek KEDS për zhvendosjen e shtyllave, të cilët një pjesë të shtyllave tashmë veç se i kanë zhvendosur dhe për pjesën tjetër jemi në pritje të tyre t'i zhvendosur.

-pjerrtësia e rrjedhës së ujërave atmosferik është e punuar sipas normave teknike dhe duke iu përshtatur edhe terrenit

-sa i përket plasaritjeve të mureve mbrojtëse apo çfarëdo dëmtimi të elementeve përbërëse të rrugës, nga operatori ekonomik i cili ka kryer punimet Komuna e Kaçanikut ka 365 ditë (1 vit) garancion për përmirësimin e ndonjë defekti eventual.

-sa i përket ankesave për kinse mashtrime të banorëve të asaj zone dhe kinse inkurajim për të votuar, kemi të bëjmë me një të pavërtetë të madhe dhe kjo ankesë po duket shumë e përgjithësuar, edhe e paargumentuar në asnjë moment.

2)

Sa i përket pretendimeve për keqpërdorim të detyrës zyrtare, për ngushtimin e rrugës përballë shtëpisë së inspektorit të ndërtimit se kinse janë shkelur të gjitha ligjet dhe rregulloret e urbanizmit dhe kadastrit dhe sa i përket merakut tuaj se kjo punë nuk është kryer përmes procedurave të kuvendit: këtu kemi të bëjmë me një të pavërtetë të madhe, pasi që gjërësia e rrugës dhe as gjërësia e trotuarit përballë shtëpisë së inspektorit nuk është ngushtuar e cila mund të vërtetohet me çfarëdo matje (gjeodezike) si dhe shihet edhe me sy.

E sa i përket 80m² të cilat i keni cekur ju njoftojme se: Kuvendi i Komunës së Kaçanikut, ku dhe ju jeni pjesë e tij, me datë 29.11.2019 me Vendimin 01Nr.464/01-36830/19 ka marrë Vendim për Shpalljen me Interes të Përgjithshëm Publik Parcela Kadastrale nr.00881-2 z.k. Kaçanik në emër të Milaim Fuga, për këmbim me Pronën Komunale nr.01855-1 z.k. Kaçanik. Pra çdo ndryshim i parcelave është bërë përmes procedurave të rregullta gjë që edhe MAPL e ka pranuar si të rregullt. Ndryshimet përfshijnë 79m², si dhe nuk pengojnë fare në gjërësinë e rrugës dhe as të trotuarit.

Inspektor i DUKMM-së
[Signature]